

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

**UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË**

**DISERTACION
I PARAQITUR PËR TË MARRË GRADËN
SHKENCORE**

“DOKTOR”

**ME TEMË:
NDIKIMI NË FUNKSIONIN VIZUAL I TUMOREVE INTRAKRANIALË
QË PREKIN RRUGËT PAMORE**

**KANDIDATI
ERALDA LECI**

**UDHËHEQËS SHKENCOR
PROF.ASC.BIRKENA QIRJAZI**

DISERTACION
I
PARAQITUR NGA

Zj. ERALDA LECI

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

DOKTOR

**TEMA: NDIKIMI NË FUNKSIONIN VIZUAL I TUMOREVE INTRAKRANIALË QË
PREKIN RRUGËT PAMORE**

PUNOI
ERALDA LECI

UDHËHEQËS SHKENCOR
BIRKENA QIRJAZI

MBROHET MË DATË_____

PËRPARA JURISË

PROF.ASC. BESIM BOCI

KRYETAR

PROF.DR. SULEJMAN ZHUGLI

ANËTAR (OPONENT)

PROF. ASC. ALI TONUZI

ANËTAR (OPONENT)

PROF.DR. RIDVAN ALIMEHMETI

ANËTAR

PROF.DR. ARSEN SEFERI

ANËTAR

TIRANË

MIRËNJOHJE

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për ndihmën, shtysën, sugjerimet në zhvillimin dhe përmbylljen e këtij studimi për Udhëheqësen Shkencore Prof.Asc. Birkena QIRJAZI.

Falenderim për të gjithë stafin e Shërbimit të Okulistikës, QSUT, për mbështetjen në të gjitha etapat e këtij studimi.

Falenderim Shërbimit të Neurokirurgjisë, shefit të shërbimit Prof. Dr. Mentor PETRELA, që më mundësuan të punoja në ambjentet e tyre me kartelat mjekësore të pacientëve të kwtij shwrbimi.

Falenderim Shërbimit të Statistikës për gatishmërinë dhe vënien në dispozicion të kartelave mjekësore për realizimin e këtij studimi.

Së fundi, mirënjohje për familjen time, për mbështetjen dhe kohën e marrë në këtë periudhë, ky libër u dedikohet atyre.

E.L

TABELA PËRMBLEDHËSE

1. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME	
I. ANATOMIA E RRUGËVE NERVORE OPTIKE	
1. Retina	
2. Nervi optik.....	
3. Kiazma optike.....	
4. Traktet optike.....	
5. Radiacionet optike	
6. Korteksi pamor.....	
II. KRITERET E VLERËSIMIT TË FUNKSIONIT TË PAMJES.....	
1. Mprehtësia e pamjes në distancë.....	
2. Fusha vizive.....	
III. TUMORET INTRAKRANIALE QË PREKIN RRUGËT OPTIKE	
1. Tumoret që prekin nervin optik.....	
2. Tumoret që prekin kiazmën optike	
2. MATERIALE DHE METODA	
3. REZULTATE DHE DISKUTIME.....	
4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	
5. BIBLIOGRAFIA.....	

KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME

I. ANATOMIA E RRUGËVE NERVORE OPTIKE

Rrugët pamore përfshijnë një sistem të ndërlikuar qelizash dhe zgjatimesh nervore që fillojnë në retinën e secilit sy dhe përfundojnë në korteksin visual në tru sipas renditjes:

1-Retina

2-Nervi optik

3-Kiazma optike, ku fijet nervore mediale kryqëzohen pjesërisht dhe pjesa tjetër laterale e fijeve nervore vazhdojnë rrugën në traktet optike

4-Traktet optike që përshkojnë nukleuset genikulat lateral dhe përmes radiacioneve optike përfundojnë në korteksin primar vizual

5-Radiacionet optike

6-Korteksi pamor

I.1. RETINA është shtresa e brendshme e syrit, ajo është e organizuar në shtresa si më poshtë:

I.1.a. Membrana kufizuese e brendshme – membranë bazale e formuar nga qelizat e Muller

I.1.b. Shtresa e fibrave nervore – aksonet e qelizave ganglionare

I.1.c. Shtresa e qelizave ganglionare – përmban bërthamat e qelizave ganglionare, aksonet e të cilave përbëjnë fibrat e nervit optik

I.1.d. Shtresa pleksiforme e brendshme – përmban sinapset ndërmjet aksoneve të qelizave bipolare dhe dentriteve të qelizave ganglionare dhe amakrine [1]

I.1.e. Shtresa kokrrizore e brendshme – përmban bërthamat dhe trupat e qelizave amakrine, bipolare dhe horizontale [1].

I.1.f. Shtresa pleksiforme e jashtme – projeksionet e rodeve dhe koneve, këto sinapsojnë me dendritet e qelizave bipolare [1]. Në regjonin makular kjo shtresë njihet si shtresa e fibrave të Henle.

I.1.g. Shtresa kokrrizore e jashtme – trupat qelizore të rodeve dhe koneve

I.1.h. Membrana kufizuese e jashtme – shtresë që ndan segmentin e brendshëm të fotoreceptorëve nga bërthamat e tyre

I.1.i. Konet dhe rodet

I.1.k. Epiteli retinal i pigmentuar - një shtresë qelizash kuboidale




Fig. I.1 Paraqitje skematike e shtresave të retinës

I.2- NERVI OPTIK është rreth 50 mm i gjatë, përmban rreth 1,2 milion aksone dhe shtrihet nga disku optik deri në kiazmën optike. [2,3]. Ndahet në këto pjesë përbërëse:

I.2.a. **pjesa intraokulare** – (1 mm) aksonet pa mielinë kalojnë përmes hapësirave të laminës kribroze, më pas mbështillen me mielinë duke e dyfishuar diametrin (1,5 mm në pjesën prelaminare në 3 mm retrolaminare)




Fig. I.2 Paraqitje skematike e retinës dhe pjesës intraokulare të nervit optik

I.2.b. **pjesa intraorbitale-** (25 mm) kjo pjesë e nervit ka:

- *shtresë meningeale* të plotë (që vazhdon me sklerën anteriorisht dhe me periosteumin e kockës sfenoidale posteriorisht)
- *araknoidea*
- *hapësirë subaraknoidale*
- *pia mater e brendshme.*

Ka përreth 8 mm hapësirë rreth tij që lejon lëvizje të lirë të bulbit okular.




Fig. I.3 Paraqitje skematike e pjeses intraorbitale të nervit optik

I.2.c. **pjesa intrakanalikulare** – (5-9 mm) nervi kalon në foramen optike për të vazhduar në kanalën optik në krahun e vogël të kockës sfenoidale.

I.2.d. **pjesa intrakraniale** - (12-16 mm, 4,5 mm diametër) nervi shtrihet lart, posteriorisht dhe medialisht për të formuar kiazmen optike.

I.3- KIAZMA OPTIKE

Kiazma optike (8 mm e gjatë, 12 mm e gjerë) përfaqëson bashkimin e të dy nervave optikë, kryqëzimin e fibrave nazale të tyre dhe fillimin e trakteve optikë [4]. Kiazma shtrihet direkt mbi gjendrën e hipofizës (80%), por mund edhe të vendoset relativisht anteriorisht saj ose posteriorisht. Hipofiza vetë shtrihet brenda sela turcika të kockës sfenoidale, e mbuluar nga diafragma e selës, një shtresë e dura mater ndërmjet klinoideve anteriore dhe posteriore. Brenda

kiazmës optike, fibrat që vijnë nga retina superonasale kryqëzohen relativisht posteriorisht kurse fibrat inferonazale kryqëzohen më tepër anteriorisht.

Disa nga fibrat inferonazale lakohen aq shumë përpara se të bashkohen me nervin optik të anës tjetër duke formuar gjurin e Wilbrand.

Fibrat makulare kryqëzohen në qendër dhe posteriorisht kiazmës. [4,5]




Fig. I.4. Kiazma optike dhe strukturat kockore rreth saj




Fig. I.5 Variantet anatomike normale të vendosjes së kiazmës optike në lidhje me hipofizën




Fig. I.6 Paraqitje skematike e kryqëzimit të fibrave optike në kiazmën optike

I.4- TRAKTET OPTIKE DHE NUKLEUSET GENIKULAT LATERALE (NGL)

Traktet optike shtrihen nga kiazma në nukleuset (bërthamat) genikulate laterale (që ndodhen në trupat genikulat laterale) në të cilën përfundojnë aksonet nga zonat korresponduese të retinës nga secili sy. [6,7] Brenda traktit, fibrat parvocelulare shtrihen në qendër dhe fibrat magnocelulare në periferi.

NGL është e organizuar në 6 shtresa:

- fibrat kontralaterale sinapsojnë me shtresën 1 (magnocelulare), 4 dhe 6 (parvocelulare)
- fibrat ipsilaterale me shtresën 2 (magnocelulare) 3, 5 (parvocelulare). [9]

Aksonet nga retina superiore sinapsojnë me pjesën qendrore dhe posteriore të NGL. Të dy traktet pasi dalin nga kiazma shtrihen pas drejt trupave genikulat laterale. 90 % e fibrave të nervit optik që mbarojnë këtu janë përgjegjëse për pamjen e ndërgjegjshme. 10 % e fibrave të nervit optik që nuk kalojnë përmes trupave genikulat lateral, kalojnë medialisht në trurin e mesëm për në kolikulat superiore dhe nukleusin pretektal (përgjegjëse për reflexin pupilar). [8] Në trupat genikulat lateral, aksonet e qelizave ganglionare retinale sinapsojnë me trupat qelizorë të neuroneve, duke formuar radiacionet optike.




Fig. I.7 Paraqitje skematike e fibrave optike në nukleuset genikulat laterale

Lateral Geniculate Nucleus (LGN)




Fig. I.8 Shtresat e nukleusit genikulat lateral




Fig. I.9 Paraqitje skematike e trakteve optike në nukleuset genikulate laterale, pamje laterale
 Nukleuset genikulat laterale janë pjesë e nukleuseve të talamusit. Shtrihen anterolateralisht nukleusit genikulat medial. NGL përbëhen nga një nukleus dorsal që përbën pjesën më të madhe të tij dhe një nukleus ventral.




Fig. I.10 Transmetimi i impulseve pamore nga retina në nukleus genikulat lateral

I.5- RADIACIONET OPTIKE

Aksonet e radiacioneve optike projektohen nga NGL në korteksin vizual.




Fig. I.11. Paraqitje skematike e radiacioneve optike

Fibrat nga retina superiore projektohen posteriorisht përmes lobit parietal. Fibrat nga retina inferiore projektohen përmes lobit temporal, por shmangen lateralisht rreth bririt inferior të ventrikulit për të formuar lakun e Meyer's. Fibrat makulare zakonisht shtrihen ndërmjet këtyre dy projeksioneve.




Fig. I.12 Paraqitje skematike e fibrave optike në radiacionet optike

Fijet e sipërme:

- projektohen në pjesën e sipërme të fisurës kalkarine, të quajtur kuneus
- përmbajnë informacion nga kuadrantet retinale superiore, që përfaqësojnë kuadrantet inferiore të fushës vizive
- dëmtimi i tyre shkakton kuadrantanopsi inferiore kontralaterale
- lezionet që prekin të dy kuneuset shkaktojnë hemianopsi altitudinale të ulët

Fijet e poshtme

- lakohen nga trupat genikulate laterale anteriorisht (Meyer's), pastaj posteriorisht për të përfunduar në pjesën e poshtme të sulkusit kalkarin, të quajtur girus lingual.
- përmbajnë informacion nga kuadrantet retinale inferiore, që përfaqësojnë kuadrantet superiore të fushës vizive
- dëmtimi i tyre shkakton kuadrantanopsi superiore kontralaterale
- dëmtimi i të dy giruseve linguale shkakton hemianopsi superiore altitudinale




Fig. I.13. Kuadrantanopsi e djathtë superiore. Zona e errët përfaqëson dëmtimet në fushën vizive të të dy syve, kjo është karakteristike e dëmtimit të lakut të Meyer's në anën e majtë të trurit.

I.6- KORTEKSI PAMOR

Korteksi primar vizual (V1, zona 17 Brodman, korteksi striat) është i lokalizuar në sipërfaqen mediale të dy lobeve oksipitale, në sulkusin kalkarin. Qelizat e korteksit vizual janë të organizuara në njësi bazë që përfaqësojnë zona të veçanta të fushës vizive.

Korteksi vizual primar është e përbërë nga një shtresë lënde gri në sipërfaqe dhe nga lënda e bardhë nën të. Lënda gri përmban 6 shtresa:

- traktet optike sinapsojnë më shumë me shtresën IV
- shtresat II dhe III projektohen në korteksin vizual sekondar
- shtresa IV projektohet në kolikulin superior
- shtresa VI projektohet në NGL (nukleusin genikulat lateral)

Fusha vizive e sipërme përfaqësohet në gjysmën e poshtme të sulkusit kalkarin. Fusha vizive e poshtme përfaqësohet në pjesën e sipërme të sulkusit kalkarin.




Fig. I.14 Paraqitje skematike e korteksit viziv primar




Fig. I.15 Korteksi striat, lidhja me NGL

II. KRITERET E VLERËSIMIT TË FUNKSIONIT TË PAMJES

Funksionimi normal i secilës prej strukturave të mësipërme të rrugëve pamore mundëson funksionin vizual normal, që ka të bëjë me:

II.a- *MPREHTËSIA E PAMJES NË DISTANCË*

II.b- *FUSHA VIZIVE*

II.a. *MPREHTËSIA E PAMJES NË DISTANCË (VISUSI)*

Matja e mprehtësisë së pamjes realizohet në adultë përmes tabelës Snellen, e cila përdor shkronja të lexueshme standarte me madhësi të ndryshme. [10]

Mprehtësia e pamjes në tabelën Snellen shkruhet si thyesë :

-distanca në të cilën shihet tabela

-distanca në të cilën shkronja përfshin 5 minuta harku

Visusi normal paraqitet si 6/6, pra një shkronjë në linjën 6/6 shtrihet në 5 min hark në 6 metër.

Visusi 6/60 do të thotë që në distancë 6 m nga tabela, pacienti mund të lexojë një shkronjë që një subjekt me shikim normal do ishte në gjendje ta shihte nga 60 m larg. Tabela duhet të jetë e ndriçuar mirë dhe pacienti të jetë i pozicionuar si duhet.

Visusi matet me korigjim maksimal (syze, lente kontakti), lentja me pinhole ndihmon në rastin e pacientëve me çrregullime refraksioni në vlera të vogla dhe kompenson opacifikimet e shtresës së mesme të syrit (katarakta). Çdo sy testohet veçmas. Për pacientët që kanë vështirësi në lexim, përdoret tabela me shkronja E, ku shkronja E paraqitet e rrotulluar në pozicione të ndryshme.




Fig.II.1.Tabela Snellen

Vlerësimi i mprehtësise së pamjes te fëmijët kërkon metoda të vecanta, derisa ata të jenë në gjendje të identifikojnë figura ose shkronja në tabelë. [11]

II.b- FUSHA VIZIVE NORMALE

Fusha vizive përshkruhet si një ishull shikimi në një det errësire. Ky ishull ka një kulm të mprehtë qendror, që korrespondon me fovean, me anë të rrumbullakosura. Kufijtë e shikimit shtrihen 70° superiorisht, 60° nasalisht , 75 ° inferiorisht , dhe 100 ° temporalisht. [12,13]




Fig. II.2 Paraqitje skematike e fushës vizive

Qëllimi i ekzaminimit të fushës vizive është përcaktimi i topografisë së shikimit për vlerësimin e çdo varianti të saj nga norma. Ajo ka për qëllim të zbulojë anomali dhe të ndjekë këto anomali kur pacienti është në observim ose trajtim.

Lloji i defekteve në fushën vizive ka rëndësi diagnostike. [7]

- **Skotoma** është një zonë fokale me sensitivitet të ulur e rrethuar nga një zonë me sensitivitet normal. Është **absolute** nëse stimuli me intensitet maksimal nuk shihet brenda saj (psh, njolla e verbër). Nëse një stimul me intensitet më të lartë se norma mund të perceptohet atëherë kemi **skotomë relative**. **Skotoma centrale** ka një depresion të fushës centrale, që përfshin fiksimin, por fusha periferike paraqitet normale. **Skotoma**

centrocecale shtrihet në njollën e verbër. **Skotoma arkuate** shkaktohet nga defekte në fibrat temporale të nervit. **Skotoma Siedel** duket si një zgjerim i njollës së verbër.

- **Depresioni** është një zonë me sensitivitet të reduktuar i parrethuar nga zona me sensitivitet normal. **Depresioni i gjeneralizuar** nuk ka ndonjë zonë me humbje të pamjes, por pacienti në përgjithësi ka nevojë për një stimul më të ndritshëm në të gjithë pozicionet, sesa pritshmëria në pacientet më të njëjtën moshë.

- **Defekt i gjysmëfushës, hemianopsi**

Gjysma e fushës vizive është e dëmtuar ose në depresion, zakonisht në patologjitë neurologjike




Fig. II.3 Hemianopsi homonime e djathte

- **Defekt altitudinal**

Gjysmëfusha e sipërme ose e poshtme e dëmtuar ose në depresion.




Fig. II.4 Defekt altitudinal inferior

- **Step nasal**

Skotomë relative ose absolute e fushës nasale superiore dhe inferiore




Fig. II.5 Dëmtim në fushën vizive, step nasal

- **Ishull (shikim) central.** Ka prani vetëm të një zone qendrore të fushës vizive.




Fig. II.5 Pamje qendrore

Dëmtimi në nivele të ndryshme të rrugëve pamore, shkakton defekte karakteristike të fushës vizive

- Një lezion në nervin optik të djathtë shkakton një humbje të shikimit në syrin e djathtë, gjithashtu një defekt aferent pupilar të djathtë.
- Një lezion në kiazmen optike shkakton humbje të shikimit në gjysmën temporale të fushave vizive në të dy sytë, hemianopsi bitemporale. Zakonisht ky dëmtim ndodh në rastet me tumor të hipofizës që komprimon kiazmen.
- Një lezion në traktin optik të djathtë shkakton një dëmtim të shikimit në gjysmë fushën e majtë, hemianopsi kontralaterale homonime.
- Një lezion në radiacionin e djathtë optik menjëherë pas nukleusit genikulat lateral shkakton dëmtim të shikimit në gjysmë fushën e majtë, hemianopsi kontralaterale homonime.
- Një lezion në radiacionin optik të djathtë, në *Meyer's loop*, shkakton dëmtim në kuadrantin e sipërm të gjysmë fushës së majtë.
- Një lezion në pjesën parietale të radiacionit optik të djathtë dëmton shikimin në kuadrantin e poshtëm të gjysmë fushës së majtë.
- Një lezion në korteksin vizual të djathtë mund të shkaktojë dëmtim të plotë të shikimit në gjysmëfushën e majtë, por zakonisht e ruajnë shikimin përmes foveas, mundësisht sepse zona kortikale që i korrespondon foveas, është e gjerë dhe mund të mos dëmtohet e gjitha nga një lezion i vetëm.




Fig. II.6 Dëmtimet në fushën vizive në nivele të ndryshme të prekjes së rrugëve optike

III. TUMORET INTRAKRANIALE QË PREKIN RRUGËT PAMORE

III.1- TUMORET QË PREKIN NERVIN OPTIK

Dy llojet kryesore të tumoreve që prekin nervin optik janë

III.1.a. gliomat

III.1.b. meningeomat

III.1.a GLIOMAT

Gliomat e nervit optik dhe kiazms janë shumë të lidhura me neurofibromatozën tipi 1. [14,15,16] Gliomat që prekin hipotalamusin dhe ventrikulin e tretë anterior gjithashtu janë të lidhura me neurofibromatozën. Patologjia e gliomave të rrugëve optike varion nga astrocitoma beninje në glioblastoma multiforme. [17] Gliomat që prekin kiazmen optike, ventrikulin e tretë dhe hipotalamusin, njihen si astrocitoma pilocitike juvenile, pa tipare malinje/ndryshime degjenerative.

Tumoret me histologji malinje zakonisht prekin adoleshentët dhe adultët. Përveç moshës, shpërndarja anatomike është faktor i rëndësishëm në ecurinë dhe prognozën e tumorit.

Gliomat e nervit optik ndahen në dy kategori:

-*glioma anteriore* e nervit optik, që prek nervin optik. [18]

-*glioma posteriore* e nervit optik, zakonisht e lokalizuar në kiazmen optike.

Të parat janë kryesisht beninje dhe prekin kryesisht fëmijët, rriten shumë ngadalë. [19,20,21]

Gliomat posteriore shfaqen në mosha më të rritura, kanë tendencë të kenë përmasa të mëdha dhe kanë më shumë simptoma. Këto tumore kanë përmasa të tilla që ndikojnë në fiziologjinë e hipotalamusit/obstruktojnë ventrikulin e tretë anterior, duke shkaktuar hidrocefali. Në të porsalindurit me glioma të kiazms dhe nervit optik, spektri varion nga tumore të vogla në tumore agresive që shpërhapen përmes rrugëve optike nga syri në korteksin oksipital. [22,23]

Tumoret me origjinë nga hipotalamusi ose ventrikuli i tretë anterior janë më të rrallë dhe më pak të shoqërueshëm me neurofibromatosis. Lezionet hamartoze mund të shfaqen në hipotalamus dhe në fosen interpedunkulare. Në këtë regjion shfaqen edhe astrocitomat juvenile, së bashku me astrocitomat anaplastike dhe forma të tjera malinje.

Vlerësimi i pacientëve me gliomë të nervit optik përfshin

- një histori të plotë familjare
- vlerësim të saktë të mprehtësisë së pamjes (shikimit)
- vlerësimi i simptomave të presionit intrakranial të rritur
- ndryshimi i statusit endokrin të pacientit (hipopituitarizëm dhe sindromi endokrin)

Në *ekzaminim objektiv* duhet vlerësuar:

- prania/ose jo e papiledemës ose atrofisë optike




Fig. III.1 Edemë papilare në gliomën e nervit optik të djathtë



Fig. III.2 Atrofi optike në NF 1 dhe gliomë e nervit optik të djathtë

- ulja e shikimit dhe dëmtimet në fushën vizive
- gjendja neurologjike e pacientit

Duhet treguar kujdes ndaj parametrave të rritjes dhe zhvillimit dhe pranisë së lezioneve që sugjerojnë për neurofibromatosis ose sklerozë tuberose. [24,28,29]




Fig. III.3 Neurofibromatosis tipi 1

Rezonanca magnetike, MRI me gadolium është ekzaminimi imazherik i duhur për vlerësimin e duhur të lezioneve. [25,26,27]



Fig. III.4 Glioma e nervit optik të majtë

Kur në momentin e diagnozës evidentohet një masë supraselare, zakonisht rekomandohet kirurgji dhe/ose biopsi e lezionit. Rezekimi i masës ekzofitike nga kiazma shpesh çon në përmirësim të shikimit duke ulur presionin në nervin optik. (Oakes, 1990). Gjithsesi pas ndërhyrjes kirurgjikale merret parasysh edhe ulja e mëtejshme e shikimit dhe vendosja e disfunktionit hipotalamik. [30] Indikacioni për kirurgji varet nga lloji dhe lokalizimi i tumorit që prek rrugët pamore. Në rastet e gliomës tipike unilaterale brenda orbitës, indikacioni kirurgjikal është ulja progresive e shikimit

dhe proptoza progresive. Kirurgjia është zgjidhja përfundimtare kur ka ulje të shikimit në një sy pa shtrirje të tumorit në kiazëm. Pacientët me gliomë të nervit optik me proptoze minimale dhe ruajtje të funksionit pamor vlerësohen periodikisht me ekzaminime imazherike dhe vlerësim oftalmologjik. [31,32,33,34,35] Në rastet kur vërehet shtrirje drejt kiazmës, indikohet kirurgji me rezeksion të nervit optik, edhe pjesës intrakanalikulare të tij, deri në bashkimin me kiazmën.

Astrocytomat që përfshijnë kiazmën nuk rezekehohen pa shkaktuar ulje të dukshme në shikim. Ekzaminimi imazherik në këto raste ka për qëllim realizimin e një biopsie të sigurtë pa shkaktuar ulje të mëtejshme të shikimit. Në rastet kur tumori është me përmasa të mëdha dhe shkakton hidrocefali, realizohet debulking që ruan pjesën që prek kiazmën duke liruar presionin në ventrikul.

III.1.b MENINGEOMA

Meningeomat mund të shfaqen në çdo pjesë të trurit, zakonisht ndeshen te femrat dhe lloje të ndryshme të tyre mund të prekin nivele të ndryshme të rrugëve pamore dhe hipotalamusin. [40,42,47] Meningeomat me origjinë periferike, mund të rriten jashtë mbulesës së nervit optik. Këto tumore kanë tendencë të përfshijnë shtresën durale të nervit optik dhe të ushtrojnë presion në nerv dhe okluzion të arteries oftalmike. [36,43] Kirurgjia e këtyre tumoreve rezulton në devaskularizim të nervit optik dhe verbim. [44,45,46] Indikacionet kirurgjikale janë ulja progresive e shikimit dhe proptoza. Meningeomat mund të marrin fillimin nga dura rreth forames optike, duke shtypur nervin optik dhe arterien oftalmike. [41] Në të dy rastet, (meningeomat e mbulesës së NO dhe ato të duras së forames optike) mund të jenë bilaterale. [37]




Fig. III.5 Meningeoma e mbulesës së nervit optik, dexter

Më të zakonshme janë meningeomat që e marrin fillimin nga dura e planum sfenoidale ose tuberkulum selae. Të parat shkaktojnë humbje shikimi nga dëmtimi i nervit optik, shtypje nga lart dhe spostim nga poshtë të tij. Të dytat zakonisht janë leziona supraselare dhe prekin nervat optikë dhe /ose kiazmën. Disa meningeoma e marrin origjinën nga dura e diafragma selae, duke shkaktuar humbje të shikimit të tipit kiazmal ose dëmtim të funksionit hipotalamo-hipofizar.




Fig. III.6 Meningeoma e tuberculum sellae

Tumoret me origjinë nga dura e 1/3 së brendshme të krahut sfenoidal zakonisht përfshijnë të dy sinuset kavernoze (dhe nervat brenda tyre) si dhe nervin optik të së njëjtës anë. Pacientët zakonisht paraqiten me diplopi, ptozë, anomali pupilare dhe humbje të shikimit nga dëmtimi i nervit optik. Pacientët me meningeoma të nervit optik / në regjionin kiazmal, kanë nevojë për vlerësim të kujdesshëm të funksionit vizual dhe fushës vizive të tyre. [39] Përmes ekzaminimeve laboratorike përcaktohen ndryshime hormonale. MRI me kontrast me gadolium është ekzaminimi imazherik më i përdorur. [38,48,49,50,51]

III.2. TUMORET QË PREKIN KIAZMËN OPTIKE

III.2.a. Adenoma e Hipofizës është tumor që prek gjendrën e hipofizës. [58,59]

Ndahet në tre kategori në bazë të funksionit biologjik:

- adenoma beninje (pjesa më e madhe)
- adenoma invazive 35%
- karcinoma 0,1 - 0,2 %




Fig. III.7 Paraqitje skematike e raportit të hipofizës dhe kiazmës optike




Fig. III.8 MRI, adenoma e hipofizës

- **Adenomat beninje**

- më të mëdha se 10 mm emërtohen **makroadenoma**.

- më të vogla se 10 mm emërtohen **mikroadenoma**. [52]

Shumica e tyre janë mikroadenoma, me prevalencë 16,7 %. Një pjese e tyre mbeten të pa diagnostikura dhe shpesh njihen si gjetje rastësore ose incidentaloma.

- **Adenomat Invasive** mund të invadojnë dura materin, kockat kraniale ose sfenoidale.

Shumica e adenomave të hipofizës çrregullojnë nivelin në gjak të një ose disa hormoneve të hipofizës anteriore, adenoma me hipersekretim të hormonit të rritjes GH, hormonit adrenocortikotrop ACTH, prolaktinës, hormonit folikulo-stimulues FS, hormonit stimulues të tiroides TSH. Këto emërtohen **adenoma sekretore**.

Tumoret hipersekretuese të hormonit të rritjes GH - Adenomat me hipersekretim të hormonit të rritjes në adultë shkaktojnë sindromin e akromegalisë. Kjo rezulton në rritje të ekzagjeruar të ekstremiteteve, kockave të fytyrës dhe indeve të buta, shtim të djersitjes, dëmtime dentare, pilozitet, deri në vdekje të papritur nëse nuk diagnostikohet dhe trajtohet. Akromeglia lidhet me hipertensionin, diabetin mellitus dhe sëmundjet kardiovaskulare.

Tumoret hipersekretuese të ACTH - Këto tumore hipersekretojnë ACTH, që stimulon rritjen e nivelit të kortizonit nga gjendrat mbiveshkore. Pacientët me sindromin Cushing paraqesin: akumulim të dhjemit në abdomen, facies lunata, rritje të presionit arterial, hiperglicemi, akne, osteoporozë, strie kutane, irritabilitet, depresion.

Tumoret hipersekretuese të prolaktinës - Adenomat prolaktin-sekretore janë më të zakonshmet, rreth 30% e të gjithë tumoreve të hipofizës. Hipersekretimi i prolaktinës nga adenoma e hipofizës (prolaktinoma) ndikon në çrregullimin e nivelit të hormoneve seksuale: estrogenit dhe testosteronit.

Tumoret hipersekretuese të hormonit tiroid stimulues - Hipertiroidizmi i shkaktuar nga rritja e nivelit të hormonit tiroid stimulues zakonisht nuk paraqet simptomatologji të shprehur, por nuk përjashtohen: rënie në peshë, çrregullim të ritmit kardiak, nervozizëm, meteorizëm intestinal, shtim të djersitjes.

Makroadeomat janë shkak më i shpeshtë i hipopituitarizmit, në numrin më të madh janë adenoma jo-sekretore. Adenomat josekretore përfshijnë atë grup tumoresh të hipofizës që përjashtohen nga grupi i tumoreve të mësipërme dhe shoqërohen me nivele normale ose të ulëta të GH, ACTH, TSH, FSH, prolaktinës. Këto emërtohen si: **adenoma jo funksionale /klinikisht jo funksionale**. Simptomat okulare gjenden në 60-70 % të rasteve, zakonisht me *humbje temporale të fushës vizive në një /të dy syte, ulje të pamjes, turbullim të shikimit*. [53,54] Në fazat fillestare dëmtimet periferike të fushës vizive mund të mos vihen re nga pacienti. Më e zakonshme është *turbullimi jo specifik i shikimit*, që mund të pengojë leximin.

Hemianopsia bitemporale ndodh si rezultat i komprimimit të nervit optik nga tumori, pikërisht në kiazmen optike. [56]




Fig. III.9 Defekt hemianopsik temporal në adenomën e hipofizës

Kur tumori e ka origjinën sipër kiazmës, zakonisht në kraniogaringeoma, defekti në fushën vizive paraqitet fillimisht si kuadrantanopsi bitemporale inferiore.




Figure 1 - Lower bitemporal defects demonstrated on visual field examination

Fig. III.10 Kuadrantanopsi bitemporale inferiore

Kur tumori e ka origjinën poshtë kiazmës defekti shfaqet fillimisht si kuadrantanopsi bitemporale superiore. Shtrirja laterale e tumorit mund të komprimojë nervin abducens, duke dhënë paralizë të muskulit rektus lateral dhe si rrjedhojë *diplopi*. [55] Adenoma e hipofizës mund të shkaktojë simptoma të *presionit intrakranial të rritur*. *Dhimbja e kokës* është simptomë që ndeshet në rreth 40% të pacientëve. Është jo specifike dhe perceptohet si një dhimbje konstante e nuk varet nga pozicioni ose koha gjatë ditës. Llojet e dhimbjeve të perceptuara nga pacientët janë: *migrena kronike/episodike*, *dhimbje koke therëse*, *dhimbje koke unilaterale neuralgjike që zgjat pak e*

shoqëruar me injeksion konjunktival dhe lotim, hemikrani e zgjatur. Në apopleksinë e hipofizës pacientët paraqesin dhimbje koke të fortë, të menjëhershme, e shoqëruar me ngrirje të qafës, që mund të ngjajë me hemorragjinë subaraknoidale. Adenomat jofunksionale mund të shoqërohen me nivele jonormale hormonale, të prolaktinës, hormonit të rritjes GH, kortizolit, T3, T4, hormonit folikulostimulues FSH, hormonit luteinizues LH. Matja e niveleve të këtyre hormoneve ka vlerë postoperative, sepse këto nivele mund të ndryshojnë pas kirurgjisë.

FSH, TSH, LH mund të rriten në adenomat josekretore edhe kur simptomatologjia klinike e këtyre sindromave hipersekretore është e lehtë. Një rritje e matshme e këtyre hormoneve në serum e klasifikon tumorin në kategorinë e tumoreve sekretuese të glikoproteinës. Nivelet e ulëta të FSH dhe LH mund të jenë një shenjë e hershme e hipopituitarizmit e shoqëruar me adenoma josekretore.

III.2.b KRANIOFARINGEOMA

Kraniofaringeomat janë leziona me origjinë nga mbeturinat skuamoze të xhepit të Rathke. Zakonisht janë tumore të fëmijërisë, por mund të shfaqen në çdo moshë. Në numrin më të madh të rasteve, kraniofaringeomat kanë një përfshirje të madhe supraselare (95%), duke përfshirë hapësirat selare dhe supraselare (75%). Një numër i vogël i tyre janë supraselare (20%), ndërsa lokalizimi vetëm intraselar i tyre hasset shumë rrallë (<5%). [60,61] Tumoret më të mëdha mund të shtrihen në të gjithë drejtimet, duke komprimuar kiazmën optike, ose trurin e mesëm duke dhënë hidrocefali obstruktive. Mund të ndodhë që kraniofaringeomat të paraqiten si masa indi të butë intraventrikulare, homogjene, pa kalcifikim. Ventrikuli i tretë është një lokalizim i zakonshëm. Më rrallë raportohen raste në nasofarings, fosa krani posteriore, ose në kolonën cervikale. [62]

Në *fëmijëri* kraniofaringeomat zakonisht janë të mëdha, leziona cistike, supraselare që paraqiten me *ndërprerje të rritjes dhe zhvillimit*, si pasojë e humbjes progresive të ndikimit në hipotalamus. Kraniofaringeomat mund të paraqiten me *ulje të shikimit të tipit kiazmal*, shoqëruar me *hidrocefali obstruktive* në lezionet e mëdha që shtypin ventrikulin e tretë.

Në *rini*, kraniofaringeomat paraqiten të ngjashme me adenomat e hipofizës. Në femra, është e zakonshme *amenogalaktorrea* dhe mund të shoqërohet /jo me *ulje të shikimit të tipit kiazmal*.

Te meshkujt shoqërohet me *hipopituitarizëm dhe impotencë e shoqëruar me probleme vizive*.

Në *moshat e mëdha*, tumoret paraqiten me *çrregullime të funksioneve mendore, e shoqëruar me presion intrakranial të rritur dhe humbje të shikimit*.

Vlerësimi klinik i kraniofaringeomave përfshin anamnezë të hollësishme, ekzaminim fizik, duke i kushtuar kujdes rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve, karakteristikave dytësore seksuale, funksionit seksual të të rriturve.

Ekzaminimi oftalmologjik ka të bëjë me një vlerësim të kujdesshëm të funksionit pamor, mprehtësisë së pamjes dhe fushës vizive. Në ekzaminimet laboratorike vlerësohet niveli i hormoneve të hipofizës.

Në ekzaminimet imazherike, MRI me kontrast përdoret në pacientët me presion të rritur intrakranial që kanë dhimbje koke dhe mund të paraqesin papiledemë. [63,65]. CT mund të tregojë për prani kalcifikimi të një pjese tumorale. [64]

1. MATERIALI DHE METODA

Qëllimi i studimit, nëpërmjet arritjes së objektivave të mëposhtëm, është përditësimi i protokolleve të trajtimit, përmirësimi i follow up-it të pacientëve, dhe i eficiencës së ekipeve multidisciplinare për rastet me tumore intrakraniale që prekin rrugët e pamjes.

Objektivat kryesore të këtij punimi:

- ❑ Të japim eksperiencën dhe rezultatet tona lidhur me parametrat epidemiologjikë e klinikë për sëmundjet tumorale që prekin rrugët pamore në popullatën e përgjithshme në Shqipëri.
- ❑ Të ballafaqojmë rezultatet tona në vite, me ato të referuara në literaturën bashkëkohore ndërkombëtare.
- ❑ Të evidentojmë e analizojmë lidhjet e mundshme ndërmjet të dhënave epidemiologjike dhe formave klinike, llojeve të terapive të aplikuara, prognozës dhe shkallës së invaliditetit afat-gjatë.
- ❑ Të vlerësojmë e të evidentojmë faktorë të ndryshëm prognostikë me qëllim orientimin në zgjedhjen në kohë dhe ndjekjen e strategjisë më të përshtatshme terapeutike në kushtet e shërbimit tonë.

METODOLOGJIA E STUDIMIT

Tipi i studimit

Ky është një studim përshkrues dhe eksplorativ nëpërmjet përmbledhjes së detajuar të rasteve të paraqitura në shërbimin e neurokirurgjisë pranë QSUT “Nënë Tereza” përgjatë periudhës 2012-2013. Përshkrimi i kampionit është siguruar nëpërmjet mbledhjes së informacionit sipas variablave demografike, gjeografike, klinike, terapeutike dhe ecurisë së sëmundjeve subjekte të këtij punimi.

Popullata në studim

Në këtë studim janë përfshirë 115 pacientë ku 64% (74 pacientë) janë nga të 12 qarqet e Shqipërisë, ndërkohë që 36% (41 pacientë) janë nga Kosova. Shpërndarja sipas moshës dhe gjinisë janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Variablat e moshës	Mesatarja	Mediana	Deviacioni Standart	Vlera minimale	Vlera maksimale
Vlerat (në vite)	51.2	54	16.3	9	78

Gjinia	Meshkuj (%)	Femra (%)
Vlerat	52 (45%)	63 (55%)

Kriteret e përfshirjes në studim

Kriteret e mëposhtme janë aplikuar në përzgjedhjen dhe përfshirjen e pacientëve në kampionin e këtij punimi:

1. Të jenë të shtruar në shërbimin e Neurokirurgjisë pranë QSUT në periudhën 2012 - 2013.
2. Në kartelën e tyre mjekësore të jenë diagnostikuar me një nga diagnozat e tabelës më poshtë.

U përjashtuan nga studimi pacientët me patologji të tjera të syrit, si opacifikime të kornesë, kristalinit (katarakta), patologji të retinës, nervit optik (glaucoma).

Periudha e studimit

Të gjithë pacientët e përfshirë në kampionin e këtij punimi janë shtruar pranë shërbimit të Neurokirurgjisë QSUT në periudhën 2012-2013 (sipas diagnozave të tabelës më poshtë).

Në përputhje me këtë periudhë, ky studim përshkruet synon ti shërbejë vlerësimit të shpërndarjes së patologjive pjesë e këtij studimi, në totalin e patologjive që paraqiten pranë shërbimit tonë të okulistikës.

Diagnozat			
#			
1	Makroadenoma	11	Kraniofaringeoma
2	Makroadenoma PRL (hipersekretime të prolaktinës)	12	Glioma malinje
3	Makroadenoma GH (hipersekretime I hormonit të rritjes)	13	Lezion orbite
4	Recidivë makroadenoma	14	Meta kockore oksipitale
5	Makroadenoma Cushing	15	Recidivë meningeoma
6	Meningeoma supraselare	16	Glioma hipotalamike
7	Meningeoma sfenoidale	17	Glioma talamike
8	Meningeoma oksipitale	18	Glioblastoma multiforme oksipitale GBM
9	Meningeoma selare	19	Recidivë GBM
10	Lezion oksipital		

Tab.1.1Diagnozat e pacientëve të përfshirë në studim

Parametrat e studiuar dhe analiza statistikore

Të dhënat individuale përfshijn **w** ecurinë e patologjisë gjat **w** periudh **ws** së shtrimit në spital si dhe përgjatë një kontrolli follow-up të kryer në një periudhë 6 mujore nga dalja nga spitali. Pacientët në periudhën e rikontrollit kanë kryer një ekaminim të hollësishëm oftalmologjik, me matje të mprehtësisë së pamjes, ekzaminim të fundusit të syrit, kryerjes së fushës vizive. Matja e mprehtësisë së pamjes është kryer me tabelë standarte logaritmike Snellen, e vendosur në distancë 3 m nga pacienti, e ndricuar mirë, e matur për secilin sy më vetë.

Përkeqësimi i shikimit është konsideruar ulja me dy ose më shumë rreshta në tabelën e Snellen, ose ulja e shikimit nga një metër në numërim gishtash, numërimi i gishtave në lëvizje dore para fytyrës, ose nga lëvizje e dorës në perceptim ose jo të dritës. [94]

Përmirësimi i shikimit është konsideruar nga perceptim ose jo i dritës në lëvizje dore para fytyrës, nga lëvizje dore në numërim gishtash, nga numërimi i gishtave në shikim një metër, shtimi i shikimit me dy ose më shumë rreshta në tabelë. [94]

Gjendje e njëjtë konsiderohet ruajtja e të njëjtit shikim me herën e fundit të ekzaminimit.

Fusha vizive është realizuar duke përdorur programin qendror 30-2 Humphrey Visual Field Analyzer II, para dhe pas kirurgjisë. U analizuan vetëm të dhënat që plotësuan kriteret e besueshmërisë, fixation losses më pak se 20%, gabimet fals negative më pak se 30%, gabimet fals positive më pak se 20%. Ndryshimet në fushën vizive u analizuan vecmas për syrin e majtë dhe të djathtë në të gjithë pacientët. Mean deviation (në dB) u përdor për krahasimin e ndryshimeve të fushës vizive me t-test krahasues.

Pjesa e analizës inferenciale të aplikuar në këtë kampion shpreh përlllogaritjen statistikore të disa variablave të shoqëruara me sëmundjen me qëllim vlerësimin e kontributit të këtyre variablave në shfaqjen dhe ecurinë e sëmundjes. Studimet analitike paraqesin nivelin më të lartë të studimeve epidemiologjike observuese. Ky studim synon t'i shërbejë përmbledhjes së eksperiencës së fituar dhe përmirësimit të praktikës klinike në vazhdim.

Analiza statistikore

Të dhënat fillimisht pas mbledhjes së tyre nga kartelat klinike, u organizuan në një database në excel i cili në funksion të analizës statistikore u importua dhe më pas analiza statistikore u krye me programin "the Statistical Package for the Social Sciences", versioni 26.0 (SPSS, Chicago, Illinois, USA).

Korrelacioni midis variablave të vazhdueshme u testua nëpërmjet përlllogaritjes së testit të studentit, kurse për variablat kategorike testimi u bë nëpërmjet testit chi square (χ^2). Për të dy këto teste statistikore vlera prag për përcaktimin e significancës u përcaktua $p \leq 0.05$ ku për $p \leq 0.05$ korrelacioni u konsiderua statistikisht i vlefshëm dhe për vlera $p > 0.05$ jo.

2. REZULTATE DHE DISKUTIME

Kampioni i përbërë nga 115 individë ndahet sipas gjinisë në 55% femra dhe 45 % meshkuj, e paraqitur në figurën 2.1




Fig. 2.1 –Shpërndarja e kampionit sipas gjinisë

Sipas moshës, intervali i pacientëve në studim përfshin individë nga 9 vjeç deri në 78 vjeç me mesatare 51 vjeç dhe deviacion standart 16.3 vjeç. Grafiku më poshtë, paraqet shpërndarjen sipas moshës në grupe.




Fig.2.2 – Shpërndarja e individëve sipas moshës

Pacientët me moshë deri në 20 vjeç përbëjnë 5,2 % të individëve.

Pacientët me moshë nga 21 deri në 40 vjeç përbëjnë 17,4 %.

Pacientët nga 41 deri në 60 vjeç përbëjnë grupin më të madh me 44,3 %.

Pacientët mbi 60 vjeç përbëjnë 33% të individëve.

Popullata e përfshirë në këtë studim vjen nga të 12 qarqet e vendit, ku grafiku më poshtë shpreh raportin sipas qarqeve.




Fig.2.3- Shpërndarja e kampionit sipas gjeografisë së rezidencës

Numri i më madh i pacientëve është nga Kosova, 41 pacientë. Qarku i dytë me numrin më të madh të pacientëve është Tirana, 17 pacientë, kjo edhe për shkak të popullsisë më të lartë në krahasim me qarqet e tjera të vendit. Më pas renditet Fieri, me 15 pacientë, dhe me rradhë, Shkodra, Vlora, sipas shpërndarjes në grafikun më sipër.

Në përputhje me objektivat e këtij punimi, në tabelën në vijim janë paraqitur të gjitha diagnozat e konfirmuara në 115 individët në studim:

#	Diagnozat	Frekuenca absolute	Frekuenca relative (%)
1	Makroadenoma	33	28.7
2	Makroadenoma PRL (hipersekretim të prolaktinës)	2	1.7
3	Makroadenoma GH (hipersekretim I hormonit të rritjes)	4	3.5
4	Recidivë makroadenoma	7	6.1
5	Makroadenoma Cushing	1	0.9
6	Meningeoma supraselare	1	0.9

7	Meningeoma sfenoidale	2	1.7
8	Meningeoma oksipitale	11	9.6
9	Meningeoma selare	10	8.7
10	Lezion oksipital	9	7.8
11	Kraniofaringeoma	10	8.7
12	Glioma malinje	4	3.5
13	Lezion orbite	7	6.1
14	Meta kockore oksipitale	3	2.6
15	Recidivë meningeoma	3	2.6
16	Glioma hipotalamike	1	0.9
17	Glioma talamike	1	0.9
18	Glioblastoma multiforme oksipitale GBM	5	4.3
19	Recidivë GBM	1	0.9
Total		115	100%

Tab.2.1 – Diagnozatat (në përqindje) e përfshira në studim

Për të bërë më të lehtë studimin e diagnozës në lidhje me shenjat klinike shoqëruese, meqënëse kampioni përmban një numër të kufizuar individësh (115 individë), diagnozat janë grupuar në 4 kategori sipas tabelës më poshtë:

#	Diagnoza	Kategoritë e diagnozave
1	Makroadenoma	Adenoma
2	Makroadenoma PRL	
3	Makroadenoma GH	
4	Recidivë makroadenoma	
5	Makroadenoma Cushing	
6	Makroadenoma jo sekretore	
7	Meningeoma supraselare	Meningeoma
8	Meningeoma sfenoidale	
9	Meningeoma oksipitale	

10	Meningeoma selare/supraselare	
11	Recidivë meningeoma	
12	Lezion oxipital	Glioma
13	Glioma malinje	
14	Meta kockore oxipitale	
15	Glioma hipotalamike	
16	Glioma talamike	
17	GBM oxipitale	
18	Recidivë gbm	
19	Kraniofaringeoma	Të tjera
20	Lezion orbite	

Tab.2.2 – Diagnozat e grupuara

Përkatësisht, numri I pacientëve sipas diagnozave të kategorizuara është: 47 pacientë (41%) me adenomë të hipofizës, 43 pacientë (37%) me meningeomë, 12 pacientë (11%) me glioma, 13 (11%) me diagnoza të tjera, e paraqitur në tabelën dhe grafikon më poshtë.

Grup-diagnozat	Frekuenca absolute	Përqindje
Adenomat	47	40.9
Meningeomat	43	37.4
Gliomat	12	10.4
Diagnoza te tjera	13	11.3
Total	115	100.0

Tab.2.3- Diagnozat e grupuara në përqindje




Fig.2.4- Diagnozatat e grupuara në përqindje




Fig.2.5- Shpërndarja e diagnozave në lidhje me moshën e pacientëve

Tabela më sipër paraqet shpërndarjen e grup-diagnozave sipas moshës ku vihet re që: adenomat mbizotërojnë në grupmoshën 41 – 60 vjec, gliomat në moshën deri 20 vjec, dhe meningeomat në moshën e tretë > 60 vjec. Grup-diagnozat në kampion janë të shpërndara sipas moshës së pacientëve në mënyrë statistikisht sinjifikative (chi square = 39, p value < 0.00).

Në studime të tjera është vënë re se adenomat e hipofizës ndeshen më shpesh në dhjetëvjeçarin e dytë dhe të tretë të jetës, por në varësi të llojit të tyre (sekretore/jo sekretore) kanë shpërndarje të ndryshme në varësi të moshës kur hasen dhe seksit.

Sipas literaturës, gliomat ndeshen në cdo moshë, me incidencë të ndryshme sipas grupmoshave. [85,86,87] Gliomat e gradës së ulët, LGH, janë tumoret më të zakonshme në fëmijët, ndërkohë që gliomat e gradës së lartë, HGG, janë më të shpeshta në adultë. [88]

Incidenca e meningeomave rritet me moshën, në moshën 45-54 vjec incidenca është 4,9/100000, rritet në 7,9/100000 për moshën 55-64 vjec dhe 12,8/100000 për 55-64 vjec. [84]

Për secilin individ në studim u mblodhën të dhëna në përputhje me shenjat klinike dhe ekzaminimet të cilat janë paraqitur në tabelat dhe grafikët në vijim.

Ndër këta pacientë, 103 prej tyre janë raste të reja dhe 12 recidiva.




Fig.2.6- Frekuenca e recidivave në kampionin në studim

Pavarësisht diagnozës dhe lokalizimit të tumorit, dhimbja e kokës është një nga ankesat e shpeshta të pacientëve të përfshirë në studim. Grafiku në vijim paraqet shpërndarjen e rasteve me këtë ankesë sipas kohëzgjatjes së dhimbjes së kokës bazuar në anamnezën e cdo rasti.




Fig.2.7- Prania e dhimbjes së kokës si shenjë klinike, kohëzgjatja

62 pacientë paraqesin dhimbje koke me kohëzgjatje të ndryshme në momentin e marrjes së anamnezës:

